



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmara • Ombudsperson Institution**

---

**UDHËZUES PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË KRIMIT TË URREJTJËS**

Prishtinë

---

Rr./Ul. Migjeni nr./br. 21 • 10000 • Prishtinë/Priština • Kosovë/Kosovo  
Tel: +383 (0) 38 223 782, 223 783, 223 789 • Fax: +383 (0) 38 223 790  
[www.oik-rks.org](http://www.oik-rks.org) • [info.oik@oik-rks.org](mailto:info.oik@oik-rks.org)

|  |    |
|--|----|
| Përmbajtja   |    |
| Qëllimi.....   | 3  |
| Mandati i Avokatit të Popullit.....  | 3  |
| Përkufizimi i krimit të urrejtjes .....                                      | 4  |
| Rëndësia e hetimit të krimeve të urrejtjes .....                             | 6  |
| Incidenti i urrejtjes .....  | 7  |
| Gjuha e urrejtjes .....  | 7  |
| Diskriminimi .....   | 8  |
| Pranimi dhe trajtimi i ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit..... | 8  |
| Raportimi dhe promovimi .....  | 10 |
| Ngritja e kapaciteteve të brendshme .....                                    | 11 |
| Aneks I - Korniza ligjore vendore lidhur me krimin e urrejtjes .....         | 12 |
| Aneks II - Mbledhja e të dhënave statistikore.....                           | 18 |

## Qëllimi

Ky udhëzues ka për qëllim ofrimin e udhëzimeve për veprim dhe trajtim të rasteve të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) kundër autoriteteve publike përgjegjëse për trajtimin e rasteve të krimit të urrejtjes.

Gjithashtu, udhëzuesi përfshin edhe sqarimin e terminologjisë dhe përkufizimit për sa i përket krimit të urrejtjes, dallimet mes krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe incidenteve, legjislacionit relevant lidhur me këto krime, identifikimin e autoriteteve përgjegjëse dhe përgjegjësitë e tyre për reagim. Ky udhëzues shërben për përdorim të brendshëm në IAP gjatë hetimit të rasteve të paraqitura në IAP apo sipas detyrës zyrtare, në bazë të mandatit kushtetues dhe ligjor.

Ky udhëzues bazohet në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me instrumentet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë, me Ligjin për Avokatin e Popullit, me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me legjislacionin relevant vendor.

Përveçse në legjislacionin në fuqi, ky udhëzues bazohet edhe në Rregulloren e Punës të Avokatit të Popullit, në bazë të së cilës trajtohen të gjitha ankesat e pranuar në IAP, përfshirë edhe ankesat të cilat kanë të bëjnë me rastet e krimeve të urrejtjes. Udhëzuesi hartohet për përdorim të brendshëm me qëllim që t'i ndihmojë këshilltarët juridikë në IAP për trajtimin e ankesave të pranuar dhe hetimin e rasteve të hapura sipas detyrës zyrtare.

## Mandati i Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit është mekanizëm ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, të institucioneve dhe të personave apo të autoriteteve të tjera, që ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës.

Mandati i Avokatit të Popullit është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Sipas këtij mandati, Avokati i Popullit pranon dhe heton ankesat nga çdo person, brenda apo jashtë vendit, që pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë nga autoritetet publike të vendit.

Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga autoritetet publike.<sup>1</sup> Autoritetet publike janë të detyruara t'u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.<sup>2</sup>

Në punën e vet, Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit, si dhe ka pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 2.

<sup>2</sup> Po aty, neni 132, paragrafi 3.

<sup>3</sup> Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 3.

Në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit zhvillon hetime për ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik, lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut, të parapara me Kushtetutë, me ligje dhe me aktet të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, posaçërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.<sup>4</sup>

Avokati i Popullit mund të zhvillojë hetime me iniciativën e vet (ex officio) nëse dëshmitë, faktet, konstatimet ose njohuritë e fituara nga mjetet e informimit publik apo burime të tjera ofrojnë bazë për shkeljen e të drejtave të njeriut.

Nëse Avokati i Popullit gjatë kryerjes së hetimeve lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut vëren se ka elemente të veprës penale, mund të kërkojë nga organet kompetente hapjen e hetimeve. Avokati i Popullit mund të paraqitet edhe në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe të mbrojtjes nga diskriminimi. Avokati i Popullit nuk ndërhyr në rastet dhe as në procedura e tjera gjyqësore, përveç rasteve që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë (zvarritjet e procedurave gjyqësore dhe mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore), por mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.<sup>5</sup>

Avokati i Popullit përfaqëson mekanizmin e barazisë, i cili promovon, monitoron dhe mbështet trajtimin e barabartë pa diskriminim në bazat e përcaktuara me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.<sup>6</sup>

### **Përkufizimi i krimit të urrejtjes<sup>7</sup>**

Krimet nga urrejtja janë krime të bazuara në paragjykimet dhe si të tilla ato ndodhin çdo kund. Asnjë shoqëri nuk është immune ndaj efekteve të paragjykimit dhe të jotolerancës. Krimet individuale të bazuara në urrejtje paraqesin burim të mundshëm të konfliktit, pasi mund të përshkallëzohen si në kuptimin e numrit të incidenteve, ashtu edhe në nivelin e dhunës. Nëse kjo kuptohet dhe ndërmerren masa të fuqishme, cikli i dhunës mund të ndalet.<sup>8</sup>

Edhe pse nuk ka një përkufizim unik për krimin nga urrejtja, megjithatë, ndër përkufizimet më të pranuar dhe më të përgjithshme të krimit të urrejtjes është përkufizimi i formuluar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat

<sup>4</sup> Po aty, neni 16.

<sup>5</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 113, paragrafi 2, dhe 135, paragrafi 4; Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 10; Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 29.

<sup>6</sup> Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 9, dhe Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 13.

<sup>7</sup> Të Kuptuarit e Krimeve të Urrëjtjes, përgatitur nga OSBE-ja - Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut në bashkëpunim me OSBE-në - Misioni në Kosovë, shih në: <http://www.osce.org/odihr/104166>.

<sup>8</sup> Të Kuptuarit e Krimeve të Urrëjtjes, Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR), faqe 6.

e Njeriut (ODIHR). Përkufizimi merr parasysh dallimet kombëtare dhe ndryshimet në legjislacion, burimet, qasjen dhe nevojat, dhe kështu i mundëson çdo shteti ta përshtatë përkufizimin.

Çdo krim në të cilin objekti i sulmit zgjidhet në bazë të përkatësisë së tij apo perceptimin për përkatësinë e tij, lidhjes/raportit, mbështetjes ose anëtarësimit në një grup që është krijuar bazuar në përkatësinë apo perceptimin për përkatësinë racore, kombëtare ose etnike, gjuhës, ngjyrës, fesë, seksit, moshës, paaftësisë mendore ose fizike, orientimit seksual, ose nga një status tjetër i ngjashëm, do të konsiderohet si krim i urrejtjes.<sup>9</sup>

Edhe pse në legjislacionin e Republikës së Kosovës nuk ka ndonjë përkufizim zyrtar për krimin e urrejtjes, Marrëveshja e bashkëpunimit për trajtimin e rasteve të krimeve të urrejtjes<sup>10</sup>, krimin e urrejtjes e konsideron si çdo krim të kryer kundër një personi, grupi personash ose pasurish, të motivuar tërësisht ose pjesërisht mbi racën, ngjyrën, gjininë, identitetin gjinor, gjuhën, besimin fetar, opinionin politik ose të ndonjë opinionit tjetër kombëtar ose shoqëror, prone, gjendje ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, paaftësisë apo ndonjë statusi tjetër personal, ose për shkak të lidhjes ose afërsisë së tyre me persona që ndajnë karakteristikat e lartpërmendura.

**Pra, krimi nga urrejtja është:**

**KRIMI NGA URREJTJA = VEPRA PENALE + MOTIVI I PARAGJYKIMIT<sup>11</sup>**

Dy elemente:

• **Vepra e kryer:** Vepër penale sipas Kodit Penal.

• **Motivi nga paragjykimi:** Objektivi i zgjedhur për shkak të një karakteristike të mbrojtur.

Për t'u përcaktuar se një krim është krim i urrejtjes, duhet të shqyrtohen treguesit e paragjykimit. Këta tregues janë një ose më shumë fakte që sugjerojnë se një vepër penale mund të jetë kryer me motiv me paragjykim. Treguesit ofrojnë kritere objektive, në bazë të të cilave vlerësohet motivi i mundshëm, por jo domosdoshmërisht e provojnë se veprimet e kryerësit të veprës janë të motivuara nga paragjykimi. Treguesit e paragjykimeve duhet të përdoren për të vendosur nëse duhen hetuar më tej pikëpamjet dhe motivet e krimit. Shembuj të treguesve paragjykes përfshijnë:

- Perceptimin e viktimës/dëshmitarit.
- Komentet, deklaratat me shkrim, gjeste apo grafite/mbishkrime.
- Dallimet ndërmjet kryerësit dhe viktimës në baza kulturore, etnike, fetare etj.

<sup>9</sup> OSCE, Challenges and Responses to Hate-Motivated Incidents in the OSCE Region (Warsaw: OSCE/ODIHR, 2006), faqe 7.

<sup>10</sup> Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës, Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për trajtimin e krimeve të urrejtjes në Kosovë, datë 15 shkurt 2018.

<sup>11</sup> Të Kuptuarit e Krimeve të Urrejtjes, Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR), faqe 7.

- Paragjykime/incidente të krimeve të mëparshme.
- Grupet e organizuara të urrejtjes.
- Lokacionin dhe kohën.
- Format/frekuenca e krimeve apo incidenteve të mëhershme.
- Motivet e përziera.
- Natyrën e dhunës.

### **Rëndësia e hetimit të krimeve të urrejtjes**

Krimi i urrejtjes duhet të trajtohet me kujdes të shtuar, pasi në mungesë të reagimit të duhur mund të përkeqësohet situata, për shkak të arsyeve të deklaruara më poshtë:

- Duke pasur parasysh se autorët mendojnë se janë duke vepruar në emër të komunitetit të tyre, ata ndihen të justifikuar moralisht në sjelljen e tyre. Në qoftë se komuniteti nuk ka mënyrë efektive t'i dënojë krimet e urrejtjes, autorë të tjerë të mundshëm inkurajohen t'i vazhdojnë aktivitetet e tyre dhe numri i krimeve të urrejtjes mund të rritet.
- Krimi i urrejtjes ka tendencë të përshkallëzimit dhe kryerësit e veprave të lehta penale shpesh kryejnë edhe akte të tjera të dhunshme gjithnjë e më të rënda, në qoftë se ata nuk kapen, hetohen dhe dënohen. Madje edhe kundërvajtjet e kryera me motiv nga paragjykimi janë të rrezikshme dhe kërkojnë përgjigje të fortë.
- Nëse viktimat dhe komunitetet e tyre ndihen të pasigurt dhe të pambrojtur nga institucionet, ata kanë gjasa për t'u hakmarrë kundër pjesëtarëve të komunitetit që është fajësuar për sulmin. Kjo mund të çojë në sulme të mëtejshme, duke krijuar rritje të dhunës që çon në ndarje të rënda sociale. Në vendet me një histori të konfliktit etnik, ky është një fenomen shumë i dukshëm.

Pasojat e të gjitha veprave kriminale janë të rënda në mënyrën e tyre. Megjithatë, pasojat e krimeve të urrejtjes janë specifike në krahasim me pasojat e krimeve të tjera. Kjo specifikë reflektohet në efektet e ndryshme dhe shumë të forta që një akt i tillë zakonisht ka tek individi dhe/ose grupi të cilit ai i përket, por edhe në gjithë komunitetin shoqëror.<sup>12</sup>

Ashtu si në shumicën e krimeve të tjera, edhe viktimat e krimeve të urrejtjes janë në një gjendje mosbesimi, shoku dhe mohimi. Trazirat emocionale të viktimave të këtyre krimeve përbëhen nga zemërimi, konfuzioni, zhgënjimi, faji dhe trishtimi. Kjo gjendje emocionale, ndër të tjera, shkaktohet nga fakti se viktimat është zgjedhur në bazë të "asaj që është", pra në bazë të atyre karakteristikave që ajo nuk mund ose vështirë se mund t'i ndryshojë (p.sh. raca, feja, kombësia, orientimi seksual etj.), por edhe nga besimi i viktimës se sulmi ndaj saj/tij ose familjes së saj/tij mund të përsëritet në çdo kohë. Së fundi, burimi i zhgënjimit të veçantë për viktimën është fakti

<sup>12</sup> Karen A. McLaughlin, *Responding to Hate Crime: A Multidisciplinary Curriculum for Law Enforcement and Victim Assistance Professionals* (Newton: National Center for Hate Crime Prevention, Education Development Center, Inc., 2000)

se ekziston një besim i përhapur se sistemi shtetëror u kushton më pak rëndësi veprave kriminale të kryera nga urrejtja sesa veprave të tjera kriminale "të zakonshme".<sup>13</sup>

Shumica e viktimave të krimeve të urrejtjes përjetojnë viktimizimin dytësor kur përpiqen të marrin mbrojtjen e duhur nga institucionet që ofrojnë një mbrojtje të tillë. Një nga format më të rënda të viktimizimit të tillë ndodh kur profesionistët, në kuadrin e detyrës së tyre për të ndihmuar viktimën, shfaqin të njëjtat paragjykime si disa anëtarë të tjerë të komunitetit, ose kur minimizojnë seriozitetin e krimit për shkak të paragjykimeve personale. Duhet thënë gjithashtu se viktimizimi dytësor në këtë kuptim mund të përjetohej në të gjitha vendet (ose në të gjitha institucionet) dhe mund të ndodhë edhe në komunikimin me miqtë, familjen, zyrtarët fetarë, mediat, edukatorët etj.

### **Incidenti i urrejtjes**

Incidenti i urrejtjes është veprim i kryer nga një individ apo grup, i motivuar nga urrejtja, paragjykimi dhe anshmëria, por që nuk paraqet vepër penale. Çdokush mund të jetë viktimë e një incidenti të urrejtjes dhe kjo nuk përcaktohet nga qëllimet e autorit.

Dallimi i krimeve të urrejtjes dhe i incidenteve të urrejtjes është i rëndësishëm. Krimet e urrejtjes janë vepra penale të motivuara nga paragjykimi. Kjo do të thotë se autori i krimit ka zgjedhur viktimën ose shënjestrën e sulmit për shkak të një ose më shumë tipareve të mbrojtura, si: racën, ngjyrën, gjininë, identitetin gjinor, gjuhën, besimin fetar, opinionin politik, ose të ndonjë opinioni tjetër, kombëtar ose shoqëror, pronën, gjendje ekonomike dhe sociale, orientimin seksual, lindjen, paaftësinë apo ndonjë statusi tjetër personal, ose për shkak të lidhjes ose afërsisë së tyre me persona që ndajnë karakteristikat e lartpërmendura. Ndërsa incidentet e urrejtjes, ndonëse kryhen për shkak të motivit nga paragjykimi ndaj personave me një ose më shumë karakteristika specifike të mbrojtura, nuk paraqesin vepra penale ose nuk raportohen si të tilla.

Llojet e incidenteve të kryera për shkak të urrejtjes përfshijnë: pështyrjen; sulmet verbale ndaj një individi ose grupi; abuzimin verbal, si thirrja me emra ose shaka fyese etj.

Viktimat e incidentit të urrejtjes mund të jenë kryesisht: të kthyerit, komunitet joshumicë, personat LGBTIQ+, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera të cenueshme.

### **Gjuha e urrejtjes**

Gjuha e urrejtjes në të shumtën e rasteve i paraprinë dhunës dhe krimit të urrejtjes. Gjuha e urrejtjes krijon ndjesinë e poshtërimit, cenimit të dinjitetit njerëzor dhe frikës së vazhdueshme të individit, si dhe ndjenjën e rrezikut ndaj grupeve të cilave u drejtohet.

*Gjuha e urrejtjes nënkupton të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin kundër një personi ose grupi personash, ose që i denigrojnë ata, për shkak të karakteristikave ose statusit të tyre personal ose të atribuar si raca,*

<sup>13</sup> Po aty

*ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, moshë, paaftësia, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual.*<sup>14</sup>

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në praktikën e saj gjyqësore përkitazi me gjuhën e urrejtjes, i referohet përkufizimit të gjuhës së urrejtjes apo të kuptuarit e saj si gjuhë që i përfshin *"të gjitha format e të shprehurit të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose arsyetojnë urrejtje të bazuar mbi mostolerancë"*.<sup>15</sup>

Krimet e urrejtjes gjithashtu dallohen nga gjuha e urrejtjes. Gjuha e urrejtjes më së shpeshti nënkupton format e shprehjes që motivohen nga armiqësia, që tregojnë ose nxisin armiqësi ndaj një grupi ose personi të caktuar për shkak të përkatësisë në atë grup. Meqë gjuha e urrejtjes mund t'i nxisë ose të jetë element shoqëruar në veprat penale të urrejtjes, të dy konceptet janë të lidhura në mënyrë të ndërsjellë.<sup>16</sup>

### **Diskriminimi**

Sjelljet që përfaqësojnë akte kriminale të kryera nga urrejtja janë shpesh të lidhura me diskriminimin. Arsyeja duhet kërkuar në faktin se ajo mund të shfaqet përmes mohimit të disa të drejtave të një individi vetëm për shkak të karakteristikave të tij.

Diskriminimi në shumicën e sistemeve gjyqësore bie tërësisht nën ligjin civil dhe në vendin tonë rregullohet me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Sipas këtij ligji, parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.

Megjithëse krimet e urrejtjes mund të konsiderohen si shembull ekstrem i diskriminimit, ekziston dallim ndërmjet këtyre dy koncepteve. Në pjesën e diskriminimit mungon elementi esencial i veprës që përbën vepër penale dhe çështjet e diskriminimit mund të zgjidhen sipas së drejtës civile.<sup>17</sup>

### **Pranimi dhe trajtimi i ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit**

Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut, të parapara me Kushtetutë, me ligje dhe me

<sup>14</sup> Përkufizimi i përfshirë në Rekomandimin e ri CM/Rec (2022)16 të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare mbi luftën kundër gjuhës së urrejtjes, miratuar më 20 maj 2022.

<sup>15</sup> 7 Gündüz kundër Turqisë (nr. 35071/97), Aktgjykimi 4 dhjetor 2003, § 22.

<sup>16</sup> <https://www.osce.org/sq/mission-to-skopje/524607>

<sup>17</sup> <https://www.osce.org/sq/mission-to-skopje/524607>



instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.

- Çdo ankesë, përfshirë edhe ankesat që kanë të bëjnë me krimin e urrejtjes, pranohen në Zyrën Qendrore dhe në zyrat rajonale të IAP-së, të cilat regjistrohen dhe shqyrtohen për procedim të mëtejshëm.
- Ankesat e pranuara, të cilat kanë të bëjnë me krimet e urrejtjes, duhet të trajtohet në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe me Rregulloren e Punës të IAP-së.
- Të gjithë zyrtarët e IAP-së që kanë qasje në informata dhe dokumente konfidenciale janë të obliguar që këto informata të mos ia zbulojnë publikut apo autoriteteve.
- IAP-ja mban regjistrin elektronik me të dhënat përkatëse, të cilat regjistrohen me rastin e parashtrimit të ankesës, siç janë: të dhënat personale të ankuesit dhe natyra e shkeljes së pretenduar, përfshirë edhe ankesat për krimet e urrejtjes.
- Pas pranimit të ankesës, bëhet shqyrtimi fillestar nëse ankesa është brenda kompetencave të IAP-së. Në të gjitha rastet e vendosjes, Avokati i Popullit e njofton me shkrim ankuesin brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të ankesës.
- Në rastet kur ankesa e individit nuk është brenda kompetencave të IAP-së, këshilltari juridik i pranimit të ankesave do të ofrojë ndihmën e përshtatshme, informata të nevojshme dhe mund ta drejtojë personin tek institucioni apo organi që ka kompetencë për t'u marrë me çështjen e ankuesit.
- Gjatë hetimit të ankesës që ka të bëjë me krimin e urrejtjes, apo rastit të hapur sipas detyrës zyrtare, duhet pasur parasysh të gjitha kompetencat e Avokatit të Popullit sipas Kushtetutës, Ligjit për Avokatin e Popullit, Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Rregullores së Punës.
- Pas fillimit të hetimeve të ankesës, apo rastit të hapur sipas detyrës zyrtare, që ka të bëjë me krimin e urrejtjes, Avokati i Popullit mund të kërkojë nga Policia ose Prokuroria, të gjitha informatat për pretendimet e ankuesit dhe për veprimet hetimore në kompetencë të institucionit përgjegjës.
- Në rast se Avokati i Popullit i vlerëson të pamjaftueshme përgjigjet ose masat e ndërmarra nga organi përkatës, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë dokumente dhe informata shtesë lidhur me çështjen në trajtim nga institucionet përgjegjëse.
- Pas ofrimit të informatave apo qasjes në dokumentet e kërkuara, Avokati i Popullit vlerëson dhe analizon nëse veprimet hetimore janë në përputhje me detyrimet dhe rregullativën ligjore.
- Nëse gjatë vlerësimit dhe analizimit të informatave të pranuara nga institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit nuk gjen shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe konstaton se veprimet hetimore të organeve përgjegjëse kanë qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, vendos për përfundimin e hetimeve dhe mbylljen e rastit.

- Nëse gjatë vlerësimit dhe analizimit të informatave të pranuara nga institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, të legjisllacionit në fuqi apo hetime joefektive nga organet përgjegjëse për çështjen në trajtim, nxjerr raport me rekomandime.
- Në përputhje me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, autoritetet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor, për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.
- Nëse pas rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit, autoritetet administrative apo zyrtarët përkatës nuk ndërmarrin masat e duhura brenda afatit kohor të caktuar ose nuk arsyetojnë mosndërmarrjen e masave të rekomanduara, Avokati i Popullit ia adreson çështjen Kuvendit të Kosovës dhe mund të bëjë deklaratë publike.
- Avokati i Popullit, në rast të mosbashkëpunimit të organeve përgjegjëse gjatë hetimit të rasteve, ka të drejtë ta procedojë çështjen tek organi më i lartë kompetent, ose t'i paraqesë raport të veçantë Kuvendit, duke i propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.
- Paraqitja e ankesës tek Avokati i Popullit nuk është kusht për ngritjen e padisë dhe nuk përbën pengesë që ankuesi t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale. Në praktikë, ankuesi mund t'i drejtohet drejtpërdrejt Avokatit të Popullit dhe të paraqesë ankesë në lidhje me diskriminimin në rastet e krimit të urrejtjes. Megjithatë, ankesa drejtuar Avokatit të Popullit nuk do të thotë fillim i procedurës penale ose civile. Mundësia e inicimit të procedurës së duhur gjyqësore mbetet tek personi që ka interes legjitim për rastin.
- Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe as në procedura e tjera ligjore që janë duke u zhvilluar në gjykata, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave. Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe të mbrojtjes nga diskriminimi.
- Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit nxjerr vendim për mbyllje të rastit dhe e njofton ankuesin. Vendimi i Avokatit të Popullit është i formës së prerë.

### **Raportimi dhe promovimi**

Avokati i Popullit, në bazë të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor, u drejtohet autoriteteve përgjegjëse me kërkesa për të dhëna statistikore lidhur me procedimin apo trajtimin e rasteve të krimit të urrejtjes. Varësisht nga të dhënat statistikore të mbledhura nga autoritetet përgjegjëse për trajtimin e krimit të urrejtjes, Avokati i Popullit mund t'i bëjë të ditura qëndrimet e tij në raportin vjetor, të cilin ia prezanton Kuvendit të Republikës së Kosovës për çdo vit raportues.

Të dhënat statistikore kredibile mund të sigurojnë prova të nevojshme për avokim për përmirësimin e politikave shtetërore në parandalimin dhe luftimin e krimit të urrejtjes, por edhe për krijimin e shërbimeve për nevojat e viktimave të këtyre krimeve. Departamenti për Mbrojtje

nga Diskriminimi i Institucionit të Avokatit të Popullit mbledh të dhënat statistikore të rasteve lidhur me krimet e urrejtjes të trajtuara nga IAP si dhe mbledh të dhënat statistikore për gjendjen e përgjithshme të rasteve lidhur me krimet e urrejtjes të evidentuara dhe të trajtuara nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, si: Policia, Prokuroria dhe gjykatat.<sup>18</sup>

Avokati i Popullit po ashtu ushtron mandatin për promovimin e të drejtave të njeriut nëpërmjet ngritjes së ndërgjegjësimit të opinionit publik dhe të institucioneve publike për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Avokati i Popullit ka rol proaktiv përmes promovimit gjithëpërfshirës, diversitetit shoqëror dhe kulturor, promovimit të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe aktiviteteve të ndryshme që kontribuojnë në ngritjen e vetëdijësimit dhe të informimit, përfshirë parandalimin e rasteve të krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes.

#### **Ngritja e kapaciteteve të brendshme**

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, është e nevojshme që IAP-ja të organizojë trajnime për stafin në lidhje me reagimin, identifikimin e motivit të mundshëm paragjykes, mënyrën e trajtimit të ndjeshëm të viktimave të krimit të urrejtjes dhe vlerësimin e nevojave individuale të viktimave. Po ashtu është e nevojshme edhe ngritja e kapaciteteve për mënyrën e raportimit për këto raste.



Naim Qelaj  
Avokati i Popullit

Prishtinë, 25 mars 2024

<sup>18</sup> Informatat lidhur me mbledhjen e të dhënave statistikore përkritazi me rastet e krimeve të urrejtjes janë evidentuar në Aneksin II të këtij udhëzuesi.

## **Aneks I - Korniza ligjore vendore lidhur me krimin e urrejtjes**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

Kushtetuta, si akti më i lartë juridik, mbrohet dhe garantohet të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 1, par. 2, përcakton se Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet dhe si e tillë Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe të lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj.

### **Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]**

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe me instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Më të Rënda, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 20 shtator 2020, përmes ndryshimit të Kushtetutës, ka përfshirë Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), si instrument ligjor detyrues për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, veprim me të cilin është plotësuar korniza ligjore me standardet më të avancuara ndërkombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje.

### **Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës**

Mbrojtja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut është thelbësore dhe shumë e rëndësishme për një përgjigje efektive në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të krimin të urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes, të cilat si të tilla kërkojnë vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në disa nene specifike, përcakton sanksionet në rastet e krimeve nga urrejtja dhe gjuha e urrejtjes.

Elementi i urrejtjes (paragjykimi) ka një ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e kufijve të dënimit të paraparë në Kodi Penal. Përkatësisht, për ta arritur qëllimin e dënimit, ligjvënësi, për një numër të caktuar të veprave penale, parashih forma më të rënda të kualifikuara në rast se motivi i ekzekutimit të tyre ka qenë urrejtja (paragjykimi), gjë që reflektohet edhe në shkallën e sanksionit penal për kryerësit e atyre veprave penale. Kjo shpreh qëndrimin e shoqërisë (shtetit) për peshën e krimit të kryer nga urrejtja.

#### **Neni 70**

Rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit

*"1. Kryerësit të veprës penale i shqiptohet dënimi i paraparë për veprën e kryer penale, ndërsa dënimi më i butë ose më i rëndë mund të shqiptohet vetëm në pajtim me kushtet e parapara me këtë Kod."*

*"2. Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh, por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese:*

[...]

*2.12. nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo vepër penale të kryer ndaj personit, grupit të personave, ose pronës, motivuar në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendje ekonomike, orientim seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura, përveç nëse ndonjë nga këto karakteristika përbën element të veprës penale; [...]."*

#### **Neni 141**

Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit

*"1. Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet."*

*"2. Kushdo që në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet."*

*"3. Kushdo që kryen veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni përmes shtrëngimit, rrezikimit të sigurisë, përqeshjes së simboleve kombëtare, racore, etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet apo varrezat, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet."*

*"4. Kushdo që në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij kryen veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet."*

Kodi Penal parasheh urrejtjen si rrethanë cilësuese për veprat penale të vrasjes së rëndë, sulmit, lëndimit të lehtë trupor, lëndimit të rëndë trupor, shkeljes së statusit të barabartë të shtetasve dhe të banorëve të Republikës së Kosovës, dhe dëmtimit të pasurisë së tjetrit.

#### **Neni 173**

Vrasja e rëndë

*"1. Me dënim jo më pak se (10) dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili:*

*[...]*

*1.10. privon nga jeta personin tjetër motivuar në bazë të kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura."*

#### **Neni 184**

Sulmi

*[...]*

*"3. Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj viktimës së ndjeshme ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura, kryesi dënohet me:*

*3.1. burgim deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni; ose*

*3.2. burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 2 i këtij neni.*

*4. Gjykata mund t'i shqiptoj vërejtje gjyqësore kryesit nga ky nen, nëse kryesi provokohet nga sjellja ç'njerëzore dhe e vrazhdë e të dëmtuarit."*

#### **Neni 185**

Lëndimi i lehtë trupor

*[...]*

*"3. Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura kryesi dënohet me:*

*3.1. burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni; ose*

*3.2. burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet për veprën penale nga paragrafi 2. i këtij."*

#### **Neni 186**

## Lëndimi i rëndë trupor

[...]

*"4. Kur vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura, kryesi dënohet me:*

*4.1. burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet për veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni;*

*4.2. burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet për veprën penale nga paragrafi 2. i këtij neni; ose*

*4.3. burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet për veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni.*

*5. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2., 3. ose 4. i këtij neni rezulton me vdekjen e personit tjetër, kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet."*

## Neni 190

Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës

*"1. Kushdo që për shkak të përkatësisë kombëtare apo etnike, racës, fesë, apo për shkak që nuk i përket ndonjërisë përkatësi, apo për shkak të bindjeve politike ose bindjeve të tjera, gjinisë, invaliditetit, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, arsimit, pozitës shoqërore, prejardhjes sociale, gjendjes materiale, apo ndonjë karakteristike tjetër personale, tjetrit ia mohon ose kufizon të drejtat e përcaktuara me Kushtetutë, ligj ose dispozita të tjera, akte të tjera të përgjithshme ose marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare, apo i jep privilegje apo favore bazuar në këto dallime, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.*

*2. Kushdo që i mohon ose ia kufizon pjesëtarit të një bashkësie etnike, fetare ose gjuhësore në Republikën e Kosovës të drejtën për shprehje të lirë të identitetit të tij ose për të gëzuar autonominë e tij, dënohet me burgim deri në një (1) vit.*

*3. Kushdo që në kundërshtim me ligjin për përdorimin e gjuhës, ia mohon shtetasit të Republikës së Kosovës të drejtën që lirshëm të përdor gjuhën ose shkrimin e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.*

*4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

*5. Kur vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet."*

## Neni 321

Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë

“1. Kushdo që e asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrethana tjera nga ato të përcaktuara në nenin 322 të këtij Kodl, dënohet me gjobë ose burgim deri në një (1) vit.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton në dëm që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) vjet deri në tre (3) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me një send që ka vlerë kulturore, fetare apo historike; ka rëndësi të posaçme shkencore, teknike apo artistike; është pjesë e koleksionit publik, koleksionit privat të mbrojtur apo e ekspozitës publike; ose është monument natyral apo objekt i natyrës nën mbrojtje; ekspozohet në publik ose është send që shërben për përdorimin publik ose për dekorimin e sheshit, rrugës apo parkut, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, pavarësisht dëmit të shkaktuar.

4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni është kryer për shkak të motivimit në bazë të kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërin nga këto karakteristika të mbrojtura, kryesi i veprës penale dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.”

#### **Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi**

##### **Neni 3 - Koncepti i diskriminimit**

“1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvlehtësoj ose çënoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikaeshme në Republikën e Kosovës.”

#### **Ligji Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit**

##### **Neni 1 - Qëllimi**

“1. Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë funksionimin e Programit për kompensim të viktimave të krimit dhe procedurave që lidhen me këtë program. [...]”

##### **Neni 2 - Fushëveprimi**

“Ky ligj rregullon të drejtën e kompensimit financiar të viktimave të veprave të dhunshme penale dhe të variësve të tyre, autoritetet vendimmarrëse si dhe procedurat për realizimin e të drejtës për kompensim në situatat vendore dhe tejkufitare.”

**Udhëzuesi për Policinë e Kosovës lidhur me trajtimin e krimeve të urrejtjes.**

**Udhëzuesi për Prokurorinë e Kosovës lidhur me trajtimin e krimeve të urrejtjes.**



**Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës, Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për trajtimin e krimeve të urrejtjes në Kosovë, datë 15 shkurt 2018.**

## **Aneks II - Mbledhja e të dhënave statistikore**

**Mbledhja e të dhënave statistikore për gjendjen e përgjithshme të rasteve lidhur me krimet e urrejtës të evidentuara nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, si: Policia, Prokuroria dhe gjykatat.**

**Mbledhja e të dhënave nga Policia e Kosovës (Pyetjet që mund t'i parashtrihen Policisë së Kosovës)**

- Sa është numri i rasteve të paraqitura në Policinë e Kosovës gjatë vitit kalendarik \_\_\_\_, të evidentuara si akte të urrejtës dhe të ndara sipas motiveve të paragjykitimit?
- Për sa prej tyre janë ngritur kallëzime penale dhe me çfarë motiveve të paragjykitimit?
- Sa prej tyre janë refuzuar dhe me çfarë motiveve të paragjykitimit?
- Sa prej tyre janë ende nën hetim dhe me çfarë motiveve të paragjykitimit?
- Sa është numri i viktimave të rasteve të paraqitura të evidentuara si akte të urrejtës, të ndara sipas motiveve të paragjykitimit?
- Sa është numri i kryerësve të rasteve të paraqitura si akte të urrejtës dhe me cilat motive të paragjykitimit?

**Mbledhja e të dhënave nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (Pyetjet që mund t'i parashtrihen Këshillit Prokurorial të Kosovës)**

- Sa është numri i kallëzimeve penale të paraqitura në prokuroritë themelore të Republikës së Kosovës, gjatë vitit kalendarik \_\_\_\_, të evidentuara si akte të urrejtës dhe të ndara sipas motiveve të paragjykitimit?
- Për sa prej tyre janë ngritur aktakuza dhe me çfarë motiveve të paragjykitimit?
- Sa prej tyre janë hedhur poshtë dhe sa janë refuzuar dhe me çfarë motiveve të paragjykitimit?
- Sa prej tyre janë ende nën hetim dhe me çfarë motiveve të paragjykitimit?
- Sa është numri i viktimave të rasteve të paraqitura të evidentuara si akte të urrejtës, të ndara sipas motiveve të paragjykitimit?
- Sa është numri i kryerësve të rasteve të paraqitura të evidentuara si akte të urrejtës, të ndara sipas motiveve të paragjykitimit?

**Mbledhja e të dhënave nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Pyetjet që mund t'i parashtrihen Këshillit Gjyqësor të Kosovës)**

- Sa është numri i lëndëve të pranuar nga Gjykatat Themelore të vendit gjatë vitit kalendarik \_\_\_\_ të evidentuara si akte të urrejtës dhe të ndara sipas motiveve të paragjykitimit?
- Sa është numri i aktgjykimeve dënuese të formës së prerë për lëndët e evidentuara si akte të urrejtës, të ndara sipas motiveve të paragjykitimit?
- Sa lëndë janë në procedurë të trajtimit në gjykatën e shkallës së parë dhe të dytë për lëndët e evidentuara si akte të urrejtës, të ndara sipas motiveve të paragjykitimit?
- Sa lëndë të evidentuara si akte të urrejtës janë refuzuar apo hedhur poshtë dhe me çfarë motiveve të paragjykitimit?